

FORCIMI I EDUKIMIT PËR QYTETARI DEMOKRATIKE NË SHQIPËRI

PLANE MËSIMORE

BASHKËPUNIMI

Si mund të punojmë së bashku në një grup online?

Mësimi bashkëpunues është thelbësor për edukimin e mirë për qytetari. Duke qenë se sot, për shkak të pandemisë së koronavirusit, edukimi për qytetari nuk mund të frekuentohet e të ndiqet më në klasë, lind nevoja që të rinjtë të mësojnë mënyra të reja bashkëpunimi me bashkëmoshatarët e tyre. Ky mësim trajton mënyrat e të punuarit së bashku për përcaktimin e rregullave të mësimi digjital, të cilat mund t'i ndihmojnë të rinjtë të krijojnë hapësira mësimi online të aksesueshme nga të gjithë nxënësit.

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- ▶ Të reflektojë mbi përfitimet e të mësuarit në grupe;
- ▶ Të analizojë pengesat e të mësuarit në grupe online dhe mënyrat për kapërcimin e tyre;
- ▶ Të identifikojë rregullat për lehtësimin e të punuarit online në grupe, që mund të aksesohen nga të gjithë;
- ▶ Të zhvillojë aftësitë e bashkëpunimit mes tyre dhe të të kuptuarit kritik të vetes.

STIMULIM

Video: <https://www.youtube.com/watch?v=V3YnWgZ-0Ds>

Shpjegoni se, pavarësisht distancimit social dhe detyrimit për të jetuar të izoluar në shtëpi, falë teknologjisë digjitale, ne mund të mblidhemi në grupe, të ndihmojmë njëri-tjetrit dhe të zgjidhim probleme. Megjithatë, mbështetja e njëri-tjetrit në këtë mënyrë, nuk është gjithnjë e lehtë. Ne duhet të mësojmë si të bashkëpunojmë dhe kjo është e rëndësishme sidomos kur gjendemi në shtëpi dhe po punojmë vetëm.

DISKUTIM

Pas videos:

- ▶ Cilat janë përparësitë e të mësuarit në grup në krahasim me studimin në mënyrë individuale? A mund të jepni shembuj të përvojave tuaja të tilla në shkollë?
- ▶ Tani që nuk jeni më në shkollë dhe po punoni nga shtëpia, cilat janë mundësitë e të mësuarit në grupe? Si mund t'ju vijë në ndihmë teknologjia?
- ▶ Cilat janë pengesat që mund të hasin nxënësit nga të punuarit në grupe?
- ▶ Çfarë mund të bëhet për t'i kapërcyer probleme të tilla?
- ▶ Çfarë mund të bëni për të garantuar pjesëmarrjen e barabartë të të gjithë anëtarëve të grupit tuaj?
- ▶ A do t'ju ndihmonte një rregullore, nëse do të kishte, për të mësuarin online në grup? Nëse po, kush do t'i krijonte rregullat dhe si?

PËRFUNDIM

Theksoni nevojën e rregullave, me qëllim krijimin e një mjedisi të hapur dhe gjithëpërfshirës mësimi, i cili është i domosdoshëm për bashkëpunimin online, ashtu siç është edhe për atë ballë për ballë. Përcaktoni tre hapa për hartimin e rregullave të grupit:

1. Mendoni se çfarë ju duhet nga të tjerët, në mënyrë që të mund të bashkëpunoni në grup;
2. Tregojuni të tjerëve pritshmëritë tuaja dhe dëgjoni pritshmëritë e tyre;
3. Negocioni së bashku dhe bini dakord për pesë rregulla.

DETYRË

Punë individuale:

- ▶ Cila sjellje e bashkëmoshatarëve tuaj mund t'ju motivojë të punoni me ta?
- ▶ Çfarë duhet të bëni, nëse nuk keni akses në disa pajisje, që ju duhen për t'u regjistruar ose nëse nuk e njihni teknologjinë që përdoret?
- ▶ Çfarë duhet të bëni, nëse disa prej bashkëmoshatarëve tuaj nuk e njohin teknologjinë që përdoret?
- ▶ Çfarë mund të bëni për t'i garantuar gjithsecilit mundësi të barabarta për shprehjen e pikëpamjeve të tij?

Punë e vogël në grup:

- ▶ Ndani pritshmëritë tuaja dhe dëgjoni pritshmëritë e të tjerëve në grupin tuaj;
- ▶ Vendosni së bashku pesë rregulla të dobishme për të gjithë;
- ▶ Vendosni se si do t'i prezantoni rregullat tuaja, në mënyrë që të përfshihen të gjithë anëtarët e grupeve.

REZULTATET

Grupet e vogla prezantojnë rregullat e tyre.

Rregullat e grupeve të vogla mblidhen së bashku për të krijuar rregullat e klasës-online.

Nëse nxënësit nuk janë të mirë në gjuhën angleze, gjeni një figurë që ilustron fuqinë e bashkëpunimit ose një thënie motivuese.

Në të kundërt, nëse klasa di anglisht, nxënësit mund ta përkthejnë videon (poezinë) në një orë mësimi dhe të diskutojnë më pas.

Jepni disa shembuj që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë se çfarë nënkuptoni me të mësuarin në grup, p.sh.: diskutime, detyra të përbashkëta, parashtrim idesh.

Sigurohuni që të dalin në diskutim çështjet e aksesit në teknologji dhe aftësitë digjitale.

Mund t'ju duhet t'i thjeshtoni disa prej këtyre pyetjeve për nxënësit më të vegjël.

Ndajini nxënësit nëpër grupe në mënyrë të tillë që nxënësit, të cilët punojnë rrallë me njëri-tjetrit, të jenë në të njëjtin grup.

Nxitni forma të reja dhe interesante prezantimi, pra: Google Slides, Visme Basic, Zoho Show.

Rregullat e përbashkëta për të gjitha grupet vendosen menjëherë në listë. Nëse një rregull është i veçantë, grupi duhet të arsyetojë mbi të dhe më pas të hidhet në votim.

BLERJET ETIKE

A lidhet gjithçka me çmimin?

Shumë njerëz po i ndryshojnë zakonet e tyre të blerjeve, pasi po u përshtaten jetës në izolim gjatë pandemisë së koronavirusit. Ky mësim trajton pasojat e mundshme të këtyre ndryshimeve në sjelljen e konsumatorit për shoqërinë në tërësi dhe rolin që mund të luajë teknologjia, duke na ndihmuar të gjejmë mënyrat më të shëndetshme, më të drejta, më mjedisore dhe më të qëndrueshme të blerjeve.

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- ▶ Të reflektojë mbi zakonet e blerjes në familjen e tyre dhe mbi mënyrat se si kanë ndryshuar këto zakone për shkak të pandemisë;
- ▶ Të analizojë arsyet e ndryshimit të zakoneve të blerjeve;
- ▶ Të identifikojë mënyra më të shëndetshme, më të drejta, më mjedisore dhe më të qëndrueshme blerjeje;
- ▶ Të zhvillojë kuptimin e drejtësisë dhe paañësisë e të menduarit kritik, si dhe kuptimin e ekonomisë, mjedisit dhe të qëndrueshmërisë.

STIMULIM

Anketë në grup:

Pyetini nxënësit se si ka ndryshuar mënyra e blerjes së ushqimeve në familjen e tyre që prej shpërthimit të pandemisë. Për shembull, a po blejnë ata:

- ▶ më shpesh, apo më rrallë?
- ▶ në dyqane të vogla, apo në supermarkete të mëdha?
- ▶ fizikisht/personalisht, apo online?

A po blejnë:

- ▶ më shumë, apo më pak ushqime?
- ▶ ushqime më të freskëta/të përpunuara, apo të shpejta e të gatshme (*fast food*)?

A po i kultivojnë më shumë vetë ushqimet e tyre? A po i gatuajnë më shumë vetë ushqimet? A është çmimi më shumë, apo më pak i rëndësishëm? A ka pasur ndryshime të tjera?

Krijoni anketën tuaj. Në internet ka shumë platforma anketash online falas, p.sh. [Google Forms](#).

Pasqyrojini të dhënat e anketës në grafik online ose kërkojuni nxënësve ta bëjnë këtë gjë.

DISKUTIM

Pas anketës:

- ▶ Çfarë të dhënash ju jep anketa për ndryshimet që ka pësuar blerja, që prej shpërthimit të virusit?
- ▶ Si mendoni, cilat janë arsyet e këtyre ndryshimeve?
- ▶ A mendoni se këto ndryshime do t'i bëjnë njerëzit:
 - më të shëndetshëm?
 - më të mirë për mjedisin?
 - më të drejtë për njerëzit që prodhojnë ushqime?
- ▶ Çfarë ndikon normalisht në zgjedhjet e njerëzve kur blejnë ushqime?
- ▶ Si mund të binden njerëzit që t'i marrin parasysh këta faktorë gjatë blerjeve?
- ▶ Cili është përgjegjës në shoqëri për të garantuar se ushqimi që ne blejmë është i shëndetshëm, i mirë për mjedisin dhe i drejtë për prodhuesit e ushqimit?

Jepni disa shembuj që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë se çfarë është të mësuarit në grup, p.sh. diskutime, detyra të përbashkëta, hedhje idesh.

Sigurohuni që çështjet e aksesit në teknologji dhe aftësitë digjitale të dalin në diskutim.

PËRFUNDIM

Përmbledhni pikat kryesore të diskutimit.

Përsëritni idenë se kur blejmë ushqime, ne nuk vendosim duke u bazuar vetëm te çmimet dhe shijet, por zgjedhjet tona bazohen edhe rreth shëndetit, mjedisit dhe paañësisë e drejtësisë në shoqëri. Përshtatja shkurtimisht fazat kryesore të zinxhirit të furnizimit ushqimor në vendin tuaj. Shpjegoni efektet që kanë zgjedhjet tona si konsumator mbi to.

Përpikuni të gjeni një infografik të përshtatshëm, p.sh. <https://www.futurelearn.com/courses/explore-how-farmers-produce-food-sustainably/0/steps/60769>

DETYRË

Nxënësit imagjinojnë sikur po ndihmojnë në projektimin e një aplikacioni, që konsumatorët mund ta përdorin për të udhëzuar zgjedhjet e tyre të blerjeve. Aplikacioni do të skanojë çdo produkt me barkod, duke i dhënë atij një klasifikim. Nxënësit duhet të zgjedhin një aspekt blerjeje që do të adresojë aplikacioni i tyre: pra, shëndetin, mjedisin ose drejtësinë. Ata hartojnë një listë me kritere, që do të përdoren nga aplikacioni dhe mbi bazën e të cilëve ai do të bëjë klasifikimin.

Ka shumë aplikacione të këtilla të disponueshme. Nxënësit më të mëdhenj mund të duan t'i analizojnë disa prej tyre ose madje edhe ta projektojnë një të tillë vetë. Shih <https://bit.ly/3axohWx>

REZULTATET

Nxënësit i paraqesin idetë e tyre për aplikacionin dhe shpjegojnë arsyet pas tyre.

Ata marrin në konsideratë përdorimet praktike të një aplikacioni të tillë dhe çfarë do ta bindte dikë të përdorë një aplikacion të tillë.

Ata reflektojnë mbi ndryshimet e formave të tjera të blerjes prej pandemisë dhe marrin në konsideratë implikimet etike të tyre, si p.sh. veshjet dhe moda.

Ose ata mund të diskutojnë avantazhet dhe disavantazhet e blerjeve online sa i përket shëndetit, mjedisit, drejtësisë.

FJALA E TË RINJVE

Po pikëpamjet tona?

Masat e rrepta të ndërmarra nga qeveritë për menaxhimin e pandemisë së koronavirusit kanë vendosur shumë kufizime në jetët e të rinjve dhe të familjeve të tyre. Megjithatë, fjalës së vetë të rinjve i është lënë pak hapësirë në këtë çështje. Ky mësim trajton të drejtën e lirisë së shprehjes dhe atë çka nënkupton ajo për fëmijët dhe të rinjtë në moshën digjitale. Ai thekson nevojën për angazhimin e nxënësve në çështje aktuale dhe të diskutueshme, si dhe demonstroi se si mund të arrihet kjo në klasën virtuale.

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- ▶ Të reflektojë mbi mendimet dhe ndjesitë e tij/saj rreth mënyrës së trajtimit të pandemisë;
- ▶ Të analizojë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe atë çka nënkupton ajo për fëmijët dhe të rinjtë;
- ▶ Të identifikojë mënyrat se si teknologjia mund t'i ndihmojë ata të shprehin pikëpamjet e tyre sociale dhe politike;
- ▶ Të zhvillojë aftësitë e tyre komunikuese dhe të mendësisë së hapur ndaj besimeve, botëkuptimeve dhe praktikave të tjera.

STIMULIM

Video:

<https://www.independent.co.uk/news/uk/home-news/coronavirus-uk-lockdown-boris-johnson-rules-restrictions-stay-home-police-a9420231.html>

Ose

<https://www.theguardian.com/world/2020/mar/25/uk-coronavirus-lockdown-rules-what-you-can-and-cannot-do>

Kërkoni një video që shpjegon rregullat e vendosura për trajtimin e pandemisë në vendin tuaj. Ose tregojini këto rregulla në një mënyrë tjetër, p.sh. përmes një kuizi.

Përkrahuni rregullat me aq hollësi sa të jenë të përshtatshme për nxënësit.

DISKUTIM

Pas videos:

- ▶ Si kanë ndikuar rregullat e reja te ju dhe familja juaj?
- ▶ Çfarë mendimi keni për to? Sipas mendimit tuaj:
 - Sa të qarta janë?
 - Sa i lehtë ka qenë zbatimi i tyre?
 - Sa mirë po funksionojnë?
 - Sa të drejta janë?
- ▶ Sa i rëndësishëm është për qeverinë dëgjimi i pikëpamjeve të të rinjve si ju mbi këtë çështje dhe mbi çështje të tjera të ngjashme? Pse mendoni kështu?
- ▶ A duhet të presin të rinjtë, për t'i shprehur pikëpamjet e tyre, derisa dikush t'u kërkojë atyre ta bëjnë këtë gjë? Apo thjesht duhet të ngrenë zërin dhe të thonë atë çka ata mendojnë? Pse mendoni kështu?
- ▶ Si mund ta përdorni teknologjinë për përhapjen e pikëpamjeve tuaja në një audiencë më të gjerë? Çfarë metodash të ndryshme ekzistojnë?

Ndarja në grupe të vogla pune parapëlqehet për këtë seksion, por jo domosdoshmërisht.

Nxitini nxënësit të arsyetojnë mendimet e tyre.

Jepuni një shembull sa për të nxitur të menduarit e tyre, p.sh. propozimet për një ligj të ri, i cili ndikon negativisht te të rinjtë.

PËRFUNDIM

Diskutoni disa prej mënyrave të përdorimit të teknologjisë digjitale nga njerëzit për të shprehur pikëpamjet e tyre sociale dhe politike, siç janë: tekstet, e-mail-et, media sociale, peticionet online, faqet zyrtare të internetit (duke përfshirë qeverinë, Avokatin e Popullit, parlamentin e të rinjve, medien, OJQ-të).

Theksoni rëndësinë e zërit dhe fjalës së të rinjve mbi çështjet që i prekin drejtpërdrejt ata, si dhe mbi përfitimet që sjell kjo si për shoqërinë ashtu edhe për vetë të rinjtë.

Kërkoni për një përmbledhje të dobishme online, p.sh. <https://medium.com/swlh/how-to-avoid-slacktivism-a-guide-for-digital-activists-81b4d7b12530>

Këtu mund të përmendenen nenet 12 dhe 13 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

DETYRË

Nxënësit shkruajnë një miniblog, ku shprehin pikëpamjet e tyre rreth menaxhimit të situatës së koronavirusit në vendin e tyre. Ata i mbështesin pikëpamjet e tyre me arsyetimet përkatëse.

Kërkoni nxënësve të gjejnë nxënës të tjerë me të njëjtat pikëpamje dhe të punojnë së bashku në grup, nëse është e mundur.

REZULTATET

Nxënësit ndajnë miniblogun e tyre me njëri-tjetrin, diskutojnë së bashku dhe shqyrtojnë hedhjen e tyre në internet.

Ata bëjnë diskutime të lira mbi temat ku mendimi dhe fjala e të rinjve është me rëndësi – në shkollë, në nivel vendor, kombëtar ose ndërkombëtar.

Pas diskutimit të lirë, nxënësit shqyrtojnë nëse ndonjë prej këtyre temave mund të jetë e diskutueshme. Ata analizojnë termin "të diskutueshme", mendojnë për shembuj të tjerë çështjesh të diskutueshme dhe për mënyrat e trajtimit më të mirë të këtyre temave në diskutime.

Tregojuni nxënësve faqet e mundshme të internetit që mund të përdorin për këtë.

Mund të shqyrtoni manualin e Këshillit të Evropës: <https://edoc.coe.int/en/human-rights-democratic-citizenship-and-interculturalism/7738-teaching-controversial-issues.html>

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



www.coe.int/dce

Të drejtat dhe përgjegjësitë

MBIKËQYRJA

Kush po ju vëzhgon?

Qeveritë në mbarë botën po miratojnë mjete të reja mbikëqyrjeje në luftën për ngadalësimin e përhapjes së pandemisë së koronavirusit. Ndonëse shumica e njerëzve janë dakord me përdorimin e teknologjisë për gjurmimin e njerëzve me koronavirus, ka shqetësime se disa prej këtyre mjeteve mund të përdoren për qëllime më pak etike. Ky mësim trajton disa nga mjetet e mbikëqyrjes, që janë prezantuar së fundmi dhe pasojat e tyre për qytetarët dhe për shoqërinë.

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- ▶ Të reflektojë mbi përdorimin e teknologjisë së mbikëqyrjes për të parandaluar përhapjen e koronavirusit;
- ▶ Të analizojë ndikimin e kësaj teknologjie mbi qytetarët dhe shoqërinë;
- ▶ Të identifikojë mënyrat e pranueshme dhe të papranueshme të përdorimit të teknologjisë së mbikëqyrjes;
- ▶ Të zhvillojë njohuritë dhe të menduarin tij/saj kritik mbi botën e politikave dhe medien.

STIMULIM

1. Eksperiment mendimi:

Përfytyroni një vend, qeveria e të cilit vendos detyrimin që çdo qytetar duhet të mbajë në dorë një byzylyk biometrik, që monitoron temperaturën e trupit dhe rrahjet e zemrës në 24 orë. Informacioni që merret nuk do t'i tregonte qeverisë vetëm gjendjen shëndetësore të qytetarëve, por do t'i mundësonte monitorim të emocioneve të tyre. Për shembull, qeveria do të kishte mundësi të dinte mbi gjendjen emocionale të tyre, pra kur dikush qesh, qan ose nervozohet, edhe pse sigurisht, ky nuk qe qëllimi për të cilin u krijua byzylyku.

2. Video:

<https://www.youtube.com/watch?v=TUFzN7So6GM>

Kjo ide është marrë nga një artikull i Yuval Noah Harari: <https://www.ft.com/content/19d90308-6858-11ea-a3c9-1fe6fedcca75>

Kërkoni për video të ngjashme në gjuhën tuaj, të cilat përshkruajnë hollësisht gamën e gjerë të teknologjive të mbikëqyrjes, të përdorura gjatë pandemisë. Nëse nuk gjeni një të tillë, hiqni zërin e një prej videove këtu dhe shpjegoni se çfarë po ndodh.

DISKUTIM

Pas eksperimentit të mendimit:

- ▶ Pse mund të dëshirojnë qytetarët të mbajnë një byzylyk të tillë?
- ▶ Pse mund të dojë qeveria ta bëjë këtë gjë?
- ▶ Pse mund të dyshojnë disa qytetarë?
- ▶ A do të kishin të drejtë të dyshonin? Po/jo, pse?
- ▶ Çfarë mendoni për këtë ide në përgjithësi? A është një ide e mirë? Po/jo, pse?
- ▶ A do të ishte më mirë nëse mbajtja e byzylykut të ishte vullnetare? Po/jo, pse?

Pas videos:

- ▶ Çfarë lloj teknologjie monitoruese po përdorin qeveritë e ditëve të sotme në luftën kundër pandemisë?
- ▶ Çfarë lloj gjërash po monitorojnë?
- ▶ A është ky monitorim i detyrueshëm, apo vullnetar?
- ▶ Disa njerëz kanë dyshime për këtë. A mendoni se kanë të drejtë për dyshimet e tyre? Po/jo, pse?
- ▶ Çfarë mendoni për këtë lloj monitorimi, në përgjithësi? A është një ide e mirë? Po/jo, pse?
- ▶ A është më mirë kur monitorimi është i detyrueshëm, apo vullnetar? Cili është mendimi juaj? Pse?

Grupet dyshe ose grupet e vogla të punës janë më të përshtatshmet për këtë diskutim, por mund të përdorni edhe teknika të tjera.

Nxitini nxënësit të thonë përgjigje të shumëllojshme për çdo pyetje.

Këtu lind mundësia për të shpjeguar zhvillimet në vendin tuaj.

Kjo do të ishte një pikë e mirë për të prezantuar të drejtën për respektimin e privatësisë (KEDNJ, neni 8).

PËRFUNDIM

Bëni një përsëritje të formave të ndryshme të teknologjisë së mbikëqyrjes, si p.sh.: njohja e fytyrës me kamera CCTV, telefonat inteligjentë, dronët, Alexa etj.

Shpjegoni mënyrat e ndryshme, në të cilat, teknologjia e mbikëqyrjes mund të përdoret për të kontrolluar qytetarët, si dhe për t'i ndihmuar ata. Jepni disa shembuj aktualë, historikë ose imagjinarë.

Përpikuni të përdorni disa shembuj nga vendi ose rajoni juaj.

Kjo do të ishte pikë e mirë për të krahasuar shoqërinë demokratike me atë totalitare.

DETYRË

Nxënësit krijojnë një infografik që tregon se ku do ta vendosnin vijën e ndarjes mes mbikëqyrjes së qeverisë, e cila përcakton pranueshmërinë dhe mospranueshmërinë e saj. Ata japin shembuj për secilin prej rasteve dhe tregojnë arsyet e zgjedhjes së tyre.

Për këtë ekzistojnë një sërë platformash online që nxënësit mund t'i përdorin, p.sh. *Canva*, *Coggle* ose *Google Jamboard*.

REZULTATET

Nxënësit ndajnë infografikët e tyre.

Ata mendojnë se kush tjetër po e përdor teknologjinë për të marrë informacione mbi njerëzit, llojet e informacioneve që po merren dhe përdorimi i tyre.

Përfshini mbledhjen dhe monetarizimin e të dhënave nga kompanitë e mëdha të teknologjisë.

MUNDËSI TË REJA

Mundësia për të provuar diçka të re

Izolimi në shtëpi dhe vetëdistancimi gjatë gjendjes aktuale shëndetësore vështirëson ndjekjen e interesave dhe aktiviteteve të përditshme nga të rinjtë. Për shembull, lojërat zyrtare dhe sportet fizike duken se janë plotësisht të pamundura, po kështu dhe veprimtaritë e tjera, të tilla si: argëtimi me miqtë. Ky mësim trajton mënyrat se si teknologjia, në krizën aktuale, mund t'i ndihmojë të rinjtë që të vazhdojnë ndjekjen e interesave të tyre të përditshme, si dhe të provojnë mundësi të reja.

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- ▶ Të reflektojë mbi efektet e gjendjes aktuale shëndetësore dhe mbi interesat dhe aktivitetet e tyre të përditshme;
- ▶ Të analizojë mundësitë e reja për rekreacion dhe mësim që dalin nga situata aktuale;
- ▶ Të identifikojë mënyrat e përdorimit të teknologjisë digjitale si për të vijuar ndjekjen e interesave të tyre ekzistuese, ashtu edhe për të provuar interesa të reja;
- ▶ Të zhvillojë fleksibilitetin, përshtatshmërinë dhe tolerancën.

STIMULIM

Ushtrim reflektimi:

Në grupe dyshe, nxënësit reflektojnë mbi mënyrat se si kufizimet e vendosura, për ndalimin e përhapjes së koronavirusit, kanë ndikuar në interesat dhe veprimtaritë e tyre të përditshme, p.sh.: në shoqërim, mësim, sporte, hobe etj. Ata flasin me shokun/shoqen rreth kësaj situatë dhe shkëmbejnë përvojat e tyre rreth mënyrave se si janë prekur nga kjo pandemi, si dhe shprehin ndjenjat dhe shqetësimet për të.

Nxënësit i tregojnë pjesës tjetër të grupit përvojën e shokëve të tyre, atë çka ka ndryshuar dhe si ka ndikuar kjo situatë tek ata, p.sh. ndjenjat, shqetësimet e tyre etj.

Gjeni një platformë të përshtatshme për këtë, p.sh. WhatsApp.

Kujtojeni nxënësve të dëgjojnë me kujdes dhe të mbajnë mend pikat e tyre kryesore.

Kërkojeni nxënësve që prezantimet t'i bëjnë të shkurtra.

DISKUTIM

Pas ushtrimit të reflektimit:

- ▶ Si ndiheni kur nuk mund të bëni gjërat që ishit mësuar të bëni?
- ▶ A ka ndonjë epërsi kjo situatë? Nëse po, cilat janë ato?
- ▶ A ka mënyra të tjera për të bërë gjërat që ishit mësuar të bëni, pa dalë jashtë ose pa u takuar fizikisht me njerëzit? Jepni shembuj.
- ▶ Si mund të ndihmojë teknologjia në këtë drejtim? Sugjeroni disa ide. A mund të rekomandoni ndonjë platformë të veçantë, p.sh.: aplikacion, media sociale, faqe interneti etj.?
- ▶ A mund të përdoren disa prej këtyre platformave për të ndihmuar organizimin e mësimëve të shkollës nga shtëpia – siç është edhe ky mësim? Si?
- ▶ A ju ka ndihmuar teknologjia të zhvillonin interesa apo veprimtari të reja gjatë pandemisë, apo gjëra që nuk i kishit menduar kurrë më parë? Nëse po, çfarë?
- ▶ A po përpiqet dikush në shoqëri t'i ndihmojë të rinjtë që të krijojnë gjëra me të cilat mund të merren gjatë kohës së tyre në shtëpi? Qeveria, apo dikush tjetër? A duhet të bëjnë ata më shumë? Pse mendoni kështu?

Thjeshtoni pyetjet për nxënësit më të vegjël.

Nxënësit mund të ndihmojnë njëri-tjetrin për të menduar rreth këtyre.

Mund të gjeni informacione online për nxënësit që dëshirojnë të vazhdojnë me mësimin online, p.sh. https://ec.europa.eu/education/resources-and-tools/coronavirus-online-learning-resources_en.

Kontrolloni në internet për nisma të tilla në vendin tuaj dhe ndajini informacionet përkatëse me nxënësit.

PËRFUNDIM

Kujtojeni nxënësve arsyen e kufizimeve të tanishme.

Shpjegoni se, pavarësisht që përkohësisht nuk mund t'i kryejnë gjërat që janë mësuar të bëjnë normalisht, teknologjia mund t'i ndihmojë ata të gjejnë mënyra të tjera për të realizuar të njëjtat gjëra. Teknologjia mund t'i ndihmojë, gjithashtu, të gjejnë interesa të reja, të cilat nuk i kanë menduar kurrë më parë. Nxitini nxënësit të eksperimentojnë dhe të mos frikësohen nga gabimet, pasi të qenit kreativ përfshin edhe daljen nga kornizat dhe shikimin e gabimeve si pjesë të procesit të të mësuarit.

Ndani të dhënat e çfarëdo faqeje interneti praktike për nxënësin, që mund të ndihmojë për këtë.

DETYRË

Nxënësit mendojnë për një interes të ri që kanë zbuluar gjatë pandemisë ose për diçka që ju intereson, që mendojnë ta provojnë.

Ata përgatisin një prezantim të shkurtër për shokët e tyre të klasës, duke shpjeguar arsyet pse kanë përzgjedhur një interes të tillë.

Puna në grupe dyshe ose në grupe të vogla do të ishte e vlefshme për këtë detyrë.

Nxitini nxënësit të përdorin forma të reja ose dhe forma prezantimi kreative.

REZULTATET

Nxënësit prezantojnë idetë e tyre.

Ata shqyrtojnë mundësitë për të vijuar përdorimin e ndonjë prej teknologjive të reja, që kanë filluar të përdorin, pasi kufizimet e pandemisë të përfundojnë.

Ata reflektojnë mbi shembujt e të rinjve të tjerë, jetët e të cilëve janë më të kufizuara se jetët e tyre, p.sh. për shkak të aftësisë së kufizuar/veçantë. Ata diskutojnë se çfarë mund të bëjë shoqëria për t'i ndihmuar dhe çfarë mund të bëjnë ata personalisht apo shkolla e tyre.

Kujtojeni nxënësve të drejtat e fëmijëve për të zhvilluar plotësisht potencialin e tyre në lidhje me personalitetin, talentet dhe aftësitë e tyre mendore dhe fizike (Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 29).

PROJEKTIMI I SË ARDHMES

Si mund ta përmirësojë teknologjia pjesëmarrjen?

Përdorimi i teknologjisë për të mësuarin në shtëpi gjatë pandemisë së fundit u ka dhënë të rinjve përvojën për të qenë më të përgjegjshëm për të nxënë vetjak. Shumë prej tyre do të dëshirojnë ta vazhdojnë këtë përvojë kur të kthehen në shkollë, pasi pandemia të ketë mbaruar. Ky mësim trajton mënyrat përmes të cilave të rinjtë mund të luajnë një rol më aktiv në edukimin e tyre kur të kthehen në shkollë, si dhe trajton mënyrat se si mund të ndihmojë teknologjia në këtë drejtim.

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- ▶ Të reflektojë mbi përvojat e studimit në shtëpi dhe mbi përgjegjësitë e reja që kanë fituar (që pandemia u ka "veshur" atyre);
- ▶ Të analizojë mundësitë gjithnjë e në rritje të përfshirjes së tyre në vendimet që ndikojnë tek ata në shkollë;
- ▶ Të identifikojë mënyrat se si teknologjia mund t'i ndihmojë të bëhen pjesëmarrës më aktivë në arsimimin e tyre;
- ▶ Të zhvillojë të kuptuarit e demokracisë dhe aftësitë e të mësuarit në mënyrë të pavarur.

STIMULIM

Ushtrim reflektues:

Nxënësit reflektojnë mbi mënyrën se si e kalojnë orarin e tyre të mësimit gjatë kësaj periudhe që gjenden të izoluar në shtëpi. Ata krahasojnë një ditë mesatare mësimi në shtëpi me një ditë të tillë në shkollë përpara pandemisë. Nxënësit mendojnë për gjërat që kryejnë dhe për personat që vendosin për mënyrën dhe kohën se kur duhet të studiojnë ata. Ata i shkruajnë mendimet e tyre në formën e një table ose kllasteri (*harta e mendjes*) dhe i ndajnë ato me shokët e tjerë të klasës.

Për këtë, edhe pse nuk është e domosdoshme, do të ishte ideale puna në grupe dyshe, p.sh.: bisedat në WhatsApp.

Ekzistojnë mjete të ndryshme online falas, që mund të ndihmojnë për këtë, p.sh. Coggle për kllasterat.

DISKUTIM

Pas ushtrimit reflektues:

- ▶ Cilat mendoni se janë ndryshimet kryesore mes një dite mësimi në shtëpi dhe një dite mësimi në shkollë?
- ▶ Kush i merr vendimet në lidhje me çfarë mësoni dhe si mësoni ju në shtëpi? Kush i merr këto vendime në shkollë?
- ▶ Çfarë mendoni rreth kryerjes së detyrave të shkollës në shtëpi? Kush i merr vendimet për këtë?
- ▶ Kur të ktheheni në shkollë, a do të dëshironit të merrni më shumë vendime për veten tuaj? Po/Jo, Pse?
- ▶ Si mendoni, cilat janë disa nga vendimmarrjet për të cilat të rinjtë mund të luajnë rol më të madh në shkollë? Për çfarë gjërash nxënësit mund të vendosin vetë?
- ▶ Si mund ta përdorin shkollat teknologjinë, që të rinjtë të përfshihen më shumë në marrjen e vendimeve në shkollë?

Puna në grupe dyshe ose në grupe të vogla parapëlqehet për këtë seksion, por jo domosdoshmërisht. Mund të provoni të përdorni mjete për diskutim online, si Padlet.

Mund t'ju duhet të nxitni e të jepni shembuj, si p.sh.: votimi online për këshillin e nxënësve, një buletin informativ elektronik për nxënësit, një sondazh digjital në shkollë për bulizmin.

PËRFUNDIM

Prezantimi i konceptit të të drejtave të fëmijëve, veçanërisht i së drejtës së fëmijëve për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështje që ndikojnë mbi ta dhe për respektimin e këtyre pikëpamjeve. Ndonjëherë, kjo nënkupton aftësinë për të vendosur vetë për gjërat e tyre dhe, herë të tjera, ndarja e këtyre vendimeve me njerëzit e tjerë. Kjo, sigurisht, është në varësi të personave që përfshihen. Pa dyshim, që nuk është një e drejtë që u siguron atyre të marrin gjithçka që duan.

Lidhni këtë të drejtë me idenë e demokracisë. Shpjegoni se si e drejta për të luajtur një rol në vendimmarrje është thelbësore për demokracinë, por ajo duhet të ndahet me njerëz të tjerë.

Neni 12, Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

DETYRË

Nxënësit mendojnë për mënyrën se si mund të përdoret teknologjia, që t'i ndihmojë të rinjtë të luajnë më shumë rol në vendimmarrje, pas mbarimit të pandemisë. Ata bëjnë një prezantim pamor, duke shpjeguar idenë e tyre dhe arsytet për të cilat ajo është një ide e mirë.

Puna në grupe të vogla do të ishte ideale, por jo e domosdoshme.

Për platforma online falas, shihni: <https://www.codemom.ai/best-online-presentation-tools-for-students/>

REZULTATET

Nxënësit bëjnë prezantimet e tyre në klasë. Klasa mendon rreth avantazheve dhe disavantazheve të propozimeve të ndryshme dhe vendosin se cili është më i miri.

Ata marrin parasysh nëse mund ta bëjnë këtë prezantim realisht pasi të kthehen në shkollë, për shembull, në bordin e shkollës.

Kujtojeni nxënësve të drejtat e fëmijëve për të zhvilluar plotësisht potencialin e tyre në lidhje me personalitetin, dhuntitë dhe aftësitë mendore e fizike (Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 29).

TË JETUARIT NË IZOLIM

A mund të na ndihmojë teknologjia që t'ia dalim?

Prindërit dhe fëmijët duhet të përshtaten që të shpenzojnë shumë më shumë kohë së bashku në situatën aktuale shëndetësore. Nivelet e stresit brenda familjes janë më të larta seç kanë qenë ndonjëherë më parë. Ky mësim ka të bëjë me mënyrat se si mund të përdoret teknologjia digjitale për t'u ardhur në ndihmë prindërve dhe fëmijëve që të përballojnë trysinë që ndiejnë prej situatës aktuale dhe rolin që mund të luajë shoqëria në këtë situatë.

Nxënësi do të jetë në gjendje:

- ▶ Të reflektojë mbi llojet e stresëve që po përjetojnë familjet për shkak të masave të marra për parandalimin e përhapjes së koronavirusit;
- ▶ Të analizojë situatat e ndryshme familjare dhe shkaqet e stresit;
- ▶ Të identifikojë mënyrat se si teknologjia mund t'i ndihmojë familjet të përballojnë situatën;
- ▶ Të zhvillojë aftësi dëgjimi, vëzhgimi dhe për zgjidhjen e konflikteve.

STIMULIM

Eksperiment mendimi:

Imagjinoni Simpsons teksa janë të detyruar të përshtaten të jetojnë të izoluar gjatë pandemisë së koronavirusit. Të gjitha personazhet të mbledhura së bashku në shtëpi, pa punë, pa shkollë dhe me frikën e vazhdueshme se mos preken nga virusi.

DISKUTIM

Pas eksperimentit të mendimit:

- ▶ Si mendoni se do të reagonin Simpsons ndaj izolimit të të gjithëve së bashku në shtëpi? Si do të sillleshin ata?
- ▶ Cili do të ishte burimi më i madh i stresit për ta?
- ▶ Po familjet reale, si po reagojnë në gjendjen aktuale? Nën çfarë lloj stresi gjenden ato?
- ▶ A është i njëjti stres për të gjitha familjet? Nëse jo, çfarë do të shkaktonte përqendrim të stresit për disa familje të caktuara? Mendoni për shembuj.
- ▶ Çfarë mund të bëjnë familjet për të ndihmuar në uljen e stresit?
- ▶ Si mund të ndihmojë teknologjia për këtë? Mendoni për mënyra të ndryshme.
- ▶ A mund ta bëjë teknologjia jetën e familjes edhe më stresuese? Cilat janë këto mënyra dhe si mund të shmangen?
- ▶ A mund të mendoni një situatë ku një pjesëtar i familjes mund të kërkojë ndihmë nga jashtë?
- ▶ Kujt mund t'i drejtoheni në shoqëri, në raste kur stresi i jetës në familje bëhet shumë i madh? Si mund t'i bëni të ditura nevojat tuaja?

PËRFUNDIM

Theksoni se, ndryshe nga Simpsons, disa familje, që jetojnë të izoluar, kanë probleme reale, siç janë: sëmundjet mendore dhe dhuna në familje. Veçanërisht fëmijët janë shumë të prekur në familjet me probleme të tilla.

Shpjegoni se, ndonëse mund të mos jetë përgjigje e plotë, ekzistojnë shumë mënyra të përdorimit të teknologjisë, që mund të ndihmojnë familjet në përballimin e kësaj gjendjeje. Përmendni:

- lojërat dhe argëtimet që i ndihmojnë ata të qetësohen;
- informacionet që nuk lejojnë fëmijët të shqetësohen më tej;
- medien sociale për të qenë në kontakt me miqtë dhe për shoqërim;
- këshillimin për ndihmën vetjake;
- aplikacionet e meditimit dhe të jogas;
- linjat e ndihmës për emergjencat etj.

DETYRË

Nxënësit krijojnë *memes* për jetën e familjes në situatën e virusit COVID-19. *Memet* mund të jenë zbavitëse ose serioze, por duhet të përmbajnë një këshillë praktike, që t'i ndihmojë familjet të përpiqen të përballojnë trysinë e jetës në krizën aktuale.

REZULTATET

Bëni një prezantim me *slide* ku shfaqen *memet*, që kanë krijuar nxënësit, me qëllim që ata t'i shohin. Nxënësit ndajnë këshillat e tyre vetjake, që mund të kenë për familjet gjatë mbylljes në karantinë.

Zgjidhni një familje tjetër të famshme, të vërtetë ose imagjinare, si të dëshironi.

Puna në grupe dyshe ose në grupe të vogla do të ishte e vlefshme për këtë detyrë.

Lëri nxënësit të imagjinojnë aq sa të duan.

Mos u kërkonin nxënësve të flasin rreth familjeve të tyre, përveç nëse duan vetë.

Mund t'ju duhet t'i nxitni nxënësit me një shembull, p.sh. të jetuarit në një apartament me një dhomë, ose kur një pjesëtar i familjes ka nevojë për kujdes të veçantë ose gjendet i shtruar në spital me virus.

Përfshini elemente të tilla, si: media sociale, aplikacionet, e-mail-i, lojërat me video, faqet e internetit, MP3, librat elektronikë etj.

Mund t'ju duhet t'i nxitni nxënësit me një shembull, p.sh. dhuna.

Tregojuni nxënësve linjat vendore të ndihmës dhe çfarëdoj shërbimi tjetër përkatës, publik ose jopublik.

Këtu lind mundësia për të përmendur të drejtat e fëmijës e, në veçanti, nenin 19, të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Mund të gjeni shembuj të tjerë online, p.sh.:

<https://www.zdnet.com/article/tech-tips-and-tricks-to-cope-with-coronavirus-social-isolation-measures/>

Gjeni një platformë të përshatshme, p.sh. Microsoft Photos.

BULLIZMI KIBERNETIK

Si parandalohet dhe luftohet?

Tani që nuk mund të dalim dhe nuk mund të takohemi me shokë dhe shoqe, për shkak të emergjencës shëndetësore, marrëdhëniet tona ndikohen më shumë se kurrë nga teknologjia. Në këtë mësim trajtohet dallimi mes komunikimit ballë për ballë dhe atij virtual, lindja e bullizmit kibernetik dhe mënyrat e parandalimit të kësaj dukurie.

Nxënësit do të jenë të aftë:

- ▶ Të reflektojnë mbi mënyrat se si ndikon teknologjia në komunikim;
- ▶ Të analizojnë pasojat e bullizmit kibernetik;
- ▶ Të identifikojnë mënyrat se si ndalohet bullizmi kibernetik;
- ▶ Të zhvillojnë më tej efikasitetin e tyre, duke vlerësuar dinjitetin dhe të drejtat e njeriut.

Komunikimet reale dhe ato virtuale

STIMUL

Figura 1: Pamje e komunikimit ballë për ballë

Figura 2: Pamje e komunikimit *on line*

Video: <https://www.youtube.com/watch?v=e5sB7mndfrQ>

DISKUTIM

Pas figurës I:

- ▶ Çfarë është komunikimi?

Pas figurës II:

- ▶ Cilat janë dallimet mes komunikimit real dhe atij virtual?
- ▶ A është më e lehtë apo më e vështirë të komunikohet me dikë përmes teknologjisë? Pse?
- ▶ A e lehtëson apo e pengon prania e një ekrani marrëdhënien me të tjerët?

Pas videos:

- ▶ Cili është dallimi mes bullizmit dhe bullizmit kibernetik?
- ▶ A përbën një problem bullizmi kibernetik? Pse?
- ▶ Cilat janë pasojat e bullizmit kibernetik për individin (viktimën)?
- ▶ Cilat janë pasojat e bullizmit kibernetik për bulluesit?
- ▶ Cilat janë pasojat e bullizmit kibernetik për dëshmitarët?

Gjeni dy imazhe që janë tërheqëse për nxënësit tuaj.

Vetëm katër minutat e para. Nuk keni një variant në gjuhën amtare? Ulni volumnin dhe tregojeni vetë historinë ose gjeni një video të ngjashme në shqip.

Thjeshtojani pyetjet nxënësve.

Kalojini dy pyetjet e dyta, nëse nxënësit i trajtuan ato në përgjigjen e pyetjes së parë.

Interesohuni nëse në vendin tonë bullizmi kibernetik ka pasojat juridike dhe informojini nxënësit për këtë.

PËRFUNDIM

Përmbledhje e shkurtër për mënyrat se si ndikon teknologjia në komunikim. Monitori/ekrani ul ndjesinë e empatisë ndaj personave të tjerë të përfshirë në një bisedë. Nuk ua shohim fytyrën të tjerëve dhe as nuk mund të kuptojmë reagimin e tyre të atypëratyshëm. Mund të zgjedhim orën dhe vendin se ku dëshirojmë të komunikojmë. E kemi më të lehtë t'u hapemi njerëzve për gjëra të ndryshme.

Bullizmi kibernetik është rritur për shkak të kufizimeve të përshkallëzuara prej koronavirusit, pasi komunikimi kaloi në sferën digjitale. Kjo është shumë e rrezikshme, sepse prek jetën reale. Të paktën një herë në jetën e vet, çdo adoleshent ka qenë dëshmitar, bullues ose viktimë e bullizmit kibernetik, kështu që të gjithë duhet të bëjmë pjesën tonë për ta parandaluar.

Mësuesi

DETYRË

Nxënësit kërkojnë në internet dhe diskutojnë:

- ▶ Cilat janë format e bullizmit kibernetik?
- ▶ Çfarë mund të bësh nëse je dëshmitar i bullizmit kibernetik?
- ▶ Çfarë mund të bësh nëse je në shënjestër të bullizmit kibernetik?
- ▶ Ku mund të drejtohesh për ndihmë? Cilat organizata mund të të ndihmojnë?
- ▶ Si mund të parandalohet bullizmi kibernetik ndaj njerëzve?

Nxënësit përgatisin një prezantim me gjetjet dhe këshillat e tyre.

Nxënësit paraqesin prezantimet.

Reflektojnë mbi përvojat e kohëve të fundit. A kanë dëgjuar ata për incidente dhune që lidhen me pandeminë e koronavirusit? Si mendojnë se duhet të reagojë shoqëria ndaj këtyre rasteve? Kush e ka përgjegjësinë në shoqëri për trajtimin e këtij fenomeni?

Më mirë në grupe të vogla, por mund të bëhet edhe individualisht.

Në rast se e zgjidhni ushtrimin në grupe të vogla, jepuni nxënësve mundësinë të punojnë me shokë/shoqe të ndryshëm/me të klasës.

Nxitini nxënësit të përdorin forma të reja prezantimi.

Thjeshtojini këto pyetje për nxënësit më të vegjël në moshë.

VIJIM

LAJMET E RREME

Si mund t'i dallojmë lajmet e rreme?

Ka shumë lajme të rreme rreth koronavirusit, që qarkullojnë në mediet sociale, sidomos për kurat e rreme. Ndonjëherë, nxënësit i ndajnë me njëri-tjetrit këto lajme, pa qenë kritikë ndaj tyre, duke menduar se janë të vërteta ose thjesht argëtuese. Ky mësim trajton pasojat e qarkullimit të lajmeve të rreme dhe mënyrën se si të dallojmë lajmet e vërteta nga ato të rreme.

Nxënësit do të jenë të aftë:

- ▶ Të reflektojnë mbi pasojat e qarkullimit të lajmeve të rreme;
- ▶ Të analizojnë lloje të ndryshme lajmesh të rreme;
- ▶ Të identifikojnë teknikat për dallimin e lajmeve të rreme;
- ▶ Të zhvillojnë të menduarin analitik dhe kritik, si dhe ndjesinë e përgjegjësisë digjitale.

Aftësitë e njohjes së medias dhe të informacionit

STIMUL

Kuiz: E vërtetë/E gabuar

<https://fullfact.org/quiz/coronavirus/>

Artikull/lajm: <https://bit.ly/34lch8Z>

Mund t'ju duhet të gjeni një *kuiz* të ngjashëm në gjuhën shqipe ose të krijoni vetë një *kuiz* – por kujdesuni që të dhënat të jenë të përditësuara.

A ka lajme/artikuj të ngjashëm në shqip?

DISKUTIM

Pas *kuiz*-it:

- ▶ Si dole në *kuiz*? A të befaso i ndonjë përgjigje? Nëse po, cila? Pse?
- ▶ Pse qarkullojnë lajme të pavërteta për koronavirusin në mediet sociale?
- ▶ A shkaktojnë ato ndonjë dëm? Po/ Jo. Pse?

Pas artikullit/lajmit:

- ▶ Pse i besojnë njerëzit kurat e rreme si kjo?
- ▶ A dini ndonjë lajm tjetër të rremë rreth koronavirusit?
- ▶ Si mund ta verifikoni nëse një lajm/artikull është apo jo i rremë?
- ▶ Ku mund të drejtoheni për ndihmë?

Nëse nxënësit nuk besojnë se një lajm është i rremë, tregoni kujdes në trajtimin e çështjes.

Tregojuni nxënësve për faqe interneti serioze ose zyrtare, si p.sh. faqja e OBSH-së dedikuar Coronavirus.

PËRFUNDIM

Përmbledhni pikat kryesore të mësimin.

Kujtojuni nxënësve se sa e rëndësishme është të verifikojnë lajmet e të tregojnë kujdes para se t'i qarkullojnë ato.

Praktikoni mënyrat kryesore të verifikimit të lajmeve të rreme.

Më pas, kërkojuni nxënësve që të bëjnë një përmbledhje.

DETYRË

Nxënësit zhvillojnë aftësitë e verifikimit të lajmeve të rreme.

Video: <https://newsliteracy.ca/fakeout/learning-the-skills/>

Në grupe të vogla, nxënësit zgjedhin tri ose katër lajme mbi koronavirusin dhe verifikojnë besueshmërinë e tyre.

Ata përgatisin disa këshilla për bashkëmoshatarët për këtë çështje dhe bëjnë një prezantim.

Ka shumë video mbi këtë temë në internet.

Nxitini nxënësit që të përdorin forma risore të prezantimit digjital, duke i bërë ato sa më tërheqëse për bashkëmoshatarët e tyre.

VIJIM

Nxënësit paraqesin pikat kryesore që kanë mësuar nga kjo detyrë.

Ata shpjegojnë këshillat që do t'u jepnin bashkëmoshatarëve për këtë çështje.

Nxënësit diskutojnë për përgjegjësitë shoqërore të personave që shpërndajnë *online* lajme të rreme.

Nxënësve mund t'u jepet për të verifikuar ndonjë lajm tjetër, që mund të jetë i rremë.

SOLIDARITETI

Si mund ta mbështesim njëri-tjetrin?

Çdo ditë kemi nevojë për njëri-tjetrin, sidomos në kohë krize, si në emergjencën shëndetësore të këtyre kohëve. Për ruajtjen e demokracisë në kohë krize, qytetarët duhet të marrin përsipër përgjegjësi dhe të tregojnë solidaritet. Në këtë mësim do të trajtohen mënyrat se si mund të kontribuojnë nxënësit në procesin e bashkimit social, pavarësisht distancimit social.

Nxënësit do të jenë të aftë:

- ▶ Të reflektojnë për situatën aktuale nga këndvështrimi i njerëzve në nevojë;
- ▶ Të analizojnë format e ndryshme të të ndihmuarit;
- ▶ Të identifikojnë mënyrat përmes të cilave të mbështesin familjet dhe komunitetet e tyre;
- ▶ Të zhvillojnë empatinë dhe mendësinë qytetare.



Etika dhe empatia

STIMUL

Video I : <https://youtu.be/okpuFgbjzUQ>

Video II: <https://www.youtube.com/watch?v=uuFYIUjFoD4>

Mund të kërkonit edhe për video të ngjashme nga vendi ynë.

DISKUTIM

Pas videos I:

- ▶ Cilët janë njerëzit që mendoni se kanë nevojë për më shumë mbështetje gjatë emergjencës së koronavirusit? Hartoni një listë të njerëzve që kanë më shumë nevojë për mbështetje dhe identifikoni nevojat e tyre.
- ▶ Çfarë mund të bëjnë të tjerët për t'u dhënë atyre mbështetjen e duhur? Mendoni për disa mënyra praktike.
- ▶ Si mund të ndihmojë interneti? Sa mënyra ju vijnë ndër mend?
- ▶ A mund të rrezikojmë shëndetin, teksa ndihmojmë të tjerët gjatë kësaj kohe? Si mund t'i shmangemi rrezikut?
- ▶ A keni dëgjuar për ndonjë grup, që ofron mbështetje në komunitetin tuaj? Çfarë bëjnë ata? Si mbrohen nga virusi? A jeni përfshirë ju ose familja juaj?

Thjeshtojani pyetjet nxënësve.

Kohë e pamjaftueshme?
Kalojini disa prej pyetjeve.
Duhet më shumë kohë?
Lërin nxënësit të diskutojnë në grupe të vogla (p.sh. sipas temave të diskutimit), më pas kërkojuni që të prezantojnë opinionet e tyre para gjithë grupit duke përdorur, p.sh. hartat e trurit (*mind-maps*).

Pas videos II:

- ▶ Çfarë mund të bëjnë të rinjtë në moshën tuaj – *online* dhe *offline*?
- ▶ A mund të ketë ndonjë rrezik? Çfarë do të bënit për të qenë të sigurt?
- ▶ Si do të vepronit për t'u siguruar se nuk vini në rrezik jetën e të tjerëve?

PËRFUNDIM

Përmbledhni idetë tuaja lidhur me ndihmën që mund të japin nxënësit për familjen e tyre ose komunitetin.

Kontribut i shkurtër nga mësuesi/ja. Le të organizohemi në mënyra të ndryshme për të mbështetur njëri-tjetrin sa më mirë të mundemi. Mund t'i demonstrojmë njëri-tjetrit se jemi bashkë – çfarëdo që të ndodhë. Të rinjtë, si brezi i parë vërtet digjital, u takon të luajnë një rol të jashtëzakonshëm. Çfarë aplikacionesh/platformash/mënyrash të reja komunikimi mund të përdoren nga familjet dhe komunitetet tuaja për të ruajtur unitetin social dhe për të ndihmuar personat në nevojë?

Njerëzit duhet të mendojnë për sigurinë e vet dhe për sigurinë e të tjerëve gjatë ofrimit të formave të mbështetjes, që përfshijnë kontaktet ballë për ballë me të tjerët.

Interesohuni nëse nxënësit aktualisht, për qëllime sigurie, janë të detyruar të respektojnë ndonjë kufizim dhe sigurohuni që idetë dhe veprimet e tyre të jenë në përputhje me rregullat/kufizimet.

Theksioni rëndësinë e sigurisë. Veprimet e pakujdesshme mund të vënë jetën në rrezik.

DETYRË

Nxënësit, zgjedhin një prej mënyrave me të cilën bashkëmoshatarët mund të përdorin internetin për të ndihmuar personat në nevojë gjatë kësaj kohe. Ata mendojnë për mënyra që nuk përfshijnë daljen nga shtëpia. I shkruajnë dhe i paraqesin në mënyrë sa më tërheqëse, duke përkrahur se ku konsistojnë dhe pse do t'ua sugjeronin të tjerëve në klasë, që t'i provonin.

Mund të zhvillohet më mirë në grupe të vogla, por mund të bëhet edhe individualisht. Nëse zgjidhni ta bëni këtë ushtrim në grupe të vogla, zgjidhni grupet në mënyrë të tillë që nxënësit të kenë mundësi të punojnë me shokë/shoqe të ndryshme nga klasa.

VIJIM

Nxënësit diskutojnë rreth ideve që kanë paraqitur shokët dhe shoqet e klasës dhe vlerësojnë sa praktike janë ato. Ata mendojnë për avantazhet dhe disavantazhet. Nxitini nxënësit të provojnë vetë një prej këtyre ideve, qoftë vetëm, qoftë me shokë/shoqe.

Nxënësit diskutojnë nëse, pas mbarimit të emergjencës së koronavirusit, do të mund të kthehen në normalitetin e mëparshëm e të kujdesen vetëm për veten, apo gjithnjë do të ketë persona në nevojë për forma mbështetjeje nga të rinjtë.

Ky publikim është përkthyer dhe
botuar në gjuhën shqipe në kuadër të
projektit të Këshillit të Evropës
"Forcimi i edukimit për qytetari
demokratike në Shqipëri", i financuar
nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe
Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Mendimet e shprehura në këtë
publikim janë përgjegjësi e autorëve
dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht
politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.



Në këtë dosje mund të gjeni disa plane mësimore që kanë për qëllim të ndihmojnë nxënësit e rinj për të diskutuar çështje të rëndësishme në situatën e krijuar prej pandemisë COVID-19. Çdo plan mësimor është hartuar rreth një teme, që korrespondon me një nga fushat e Qytetarisë Digjitale e njëherësh është lidhur me rezultatet e të nxënësve, të përcaktuara në Kuadrin e Referencës për Komptencat për Kulturë Demokratike të Këshillit të Evropës, i cili mbetet dokumenti kryesor në mbështetjen e politikëbërësve, ekspertëve të arsimit dhe mësuesve për të pajisur nxënësit me aftësitë e nevojshme, që të jetojnë të gjithë bashkë e të barabartë në një shoqëri demokratike e kulturalisht të ndryshme.

Planet mësimore janë të lehta për t'u përdorur dhe fleksibël. Ato mund të mësohen në një sërë situatash të mësimi në distancë dhe të përshtaten për t'iu përshtatur platformave ose pajisjeve të disponueshme të mësimi elektronik, moshës së nxënësve, kontekstit lokal, kohës në linjë dhe nivelit të aftësive dixhitale. Format i thjeshtë ju lejon të përshtatni procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve me nevojat e nxënësve tuaj, duke u mbështetur në parimet e provuara dhe të testuara të Edukimit për Qytetarinë Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut: dialog, të menduarit kritik, të nxënësve aktiv dhe bashkëpunues.

Ky publikim është përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës "Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri", i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

SQI



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE